



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Organi Shqyrtues i Prokurimit  
Telo Za Razmatranje Nabavke - Procurement Review Body

Rr. "Migjeni" (ish Banka e Ljublanës), Kati V, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës  
Tel: +383 (0)38 312 309 - Email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

PSH.Nr. 672/23

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj Mexhuani duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik "Kompania e Sigurimeve Scardian JSC" kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 21.08.2023 të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve të Komunës së Prishtinës dhe KPSH-së" me numër të prokurimit 616-23-5923-2-1-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve me datë 25.10.2023 merr këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Kompania e Sigurimeve Scardian JSC" me nr. 672/23 e datës 08.09.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 21.08.2023 të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve të Komunës së Prishtinës dhe KPSH-së" me numër të prokurimit 616-23-5923-2-1-1.
- II. Anulohet Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues i datës 21.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.
- III. Detyrohet Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës për zbatimin e këtij vendimi si dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të vendimit të dërgoj në OSHP njoftimin lidhur me veprimet që ndërmerren për zbatimin e tij, të gjitha këto nën paralajmërimin se në rast të moszbatimit të këtij vendimi, OSHP do të ndërmer masat kundër Autoritetit Kontraktues në përputhje me nenin 131 të LPP.
- IV. **Lejohet** kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtoj kërkesë për kthimin e tarifës së ankesës në përputhje me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

## Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 12.06.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve të Komunës së Prishtinës dhe KPSH-së” me numër të prokurimit 616-23-5923-2-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 175,000.00 €.

Me datë 21.08.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë grupin e operatorëve ekonomik “Eurosig” Sh.P.K. & “Autocon” Sh.P.K.

Me datë 25.08.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 31.08.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Duke qenë i pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues operatori ekonomik ankues me datë 08.09.2023 ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 672/23.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim: “*Standart për sigurimin e automjeteve për sigurim është kubikazhi ( cm<sup>3</sup> ) për grupin tarifor I -kur veturat janë për pasagjer dhe peshë max e lejuar (ton) për Grupin tarifor II Kamionet. Veprimtaria e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia dhe sigurimet tjera të detyrueshme rregullohen me ligje të veqanta nga BQK . Ligji nr 04/L-018 për Sigurimi e detyrueshëm nga Autopërgjegjësia –*



*Neni 8 Kushtet dhe primi I sigurimit te detyrueshem. BQK-ja ka kompetencë të nxjerrë rregulla që përcaktojnë strukturën e primit që siguroesi duhet të zbatojë në caktimin e primit për sigurimin. Rregullat mund të përcaktojnë strukturën e saktë të primit, shumën minimale apo maksimale apo një kufi brenda të cilit primi duhet të jetë. Kompania fituese Eurosig ka vendosur prime të cilat nuk janë në përputhje me specifikat në dosje të tenderit ,duke bërë shkelje të tarifës dhe vendosje të cmimit të primit TPL në mospërputhje të specifikave të dhëna”.*

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59 dhe 60 të LPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues në OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 30.09.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: *“ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim”.*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Operatori ekonomik ankues pajtohet me raportin e ekspertit. Ndërsa Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit me arsyetimin si në vijim *“AK nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit, pasi që ne pretendimet e parashtruesit, lidhur me çmimin e automjeteve për sigurimin Kasko , ZPP ka kërkuar nga njesia kerkuese sqarime lidhur me vedosjen e vleres reale te automjeteve, mirepo, ne pergjigjen e njesise kerkuese thuhet: Konsiderojme se nuk kemi vleresim te sakte mbi vleren e veturave qe posedojme .Te gjitha veturat jane te relativisht te vjetra dhe si te tilla nuk kemi mundesi te ofrojme nje vleresim te tille.Si rrjedhoje ne oferten nga OE-ik, qe kane ofertuar kane dhene çmimin e tyre, dhe si te tille edhe marrin pergjegjesi. Andaj, e kemi vleresuar si te pergjegjshem”.*

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave -*

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

**Lidhur me pretendimet ankimore** në raportin e ekspertit shqyrtues ndër të tjera është vlerësuar si në vijim: *“Eksperti shqyrtues sa i përket pretendimit të parashtruar nga OE ankuesi, sqaron se, në ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar janë të vendosura disa nga çmimet të cilat*

*nuk përkojnë me tarifën e Bankës Qëndrore, dhe si e tillë AK aktivitetin e prokurimit duhet ta kthejë në rivlerësim, ku procesi i rivlerësimit të bëhet konform dispozitave ligjore të LPP-së, duke analizuar ofertat e ofertuesve sipas kërkesave dhe kriterit të kërkuar nga vet AK”.*

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues. Argumentimi i ekspertit shqyrtues është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka ofertuar tenderuesi. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues i ka falur besimin konstatimeve të ekspertit shqyrtues.

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -*

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa duhet të miratohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës të datës 21.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve të Komunës së Prishtinës dhe KPSH-së” me numër të prokurimit 616-23-5923-2-1-1, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në **Rivlerësim**, Ngase Eksperti ka sqaruar se *në ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar janë të vendosura disa nga çmimet të cilat nuk përkojnë me tarifën e Bankës Qëndrore, dhe si në rrethana të tilla AK duhet ta kthejë aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, ku procesi i rivlerësimit të bëhet konform dispozitave ligjore të LPP-së, duke analizuar ofertat e ofertuesve sipas kërkesave dhe kriterit të kërkuar nga vet AK*

Prandaj bazuar në të lartcekurat, në pretendimet ankimore dhe provat e administruara, Paneli shqyrtues, vendosi që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim, duke kërkuar nga AK që të ofroj shembullin e praktikave të mira gjatë procesin e ri-vlerësimit dhe të vlerësojë ofertat e operatorëve ekonomik në harmoni me nenin 7, 59.69 dhe 72 të LPP, të sigurojnë po ashtu që fondet publike do të përdoren në mënyrë më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në paragrafët përkatës të nenit 1 të LPP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP



dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicioj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP. Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP. Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



**Vjosa Gradinaj Mexhuani**  
Kryetare e Panelit Shqyrtues

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtoj padi në Gjykatën Komerciale - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.